



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.Regj. 1531 Them.

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTAR : Artan Lazaj

asistuar nga sekretarja gjyqësore Jonida Kurti, në Tiranë me 20.11.2014 shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me Nr.Regj 1531 Them që i përket:

KËRKUES : **E.D**, e bija e E. dhe e A. , e dtl. (.....), përfaqësuar nga e ëma A.M.

A.M e bija e B. dhe N., dtl. (.....), lindur dhe banuese ne Tirane, (.....), P. (.....) beqare, me nje femije, arsim i larte, mesuese letersie, shqiptare, identifikuar me lertenjoftimin Nr (.....), e përfaqësuar me deklaram në prani dhe në mungesë nga Av. Maksim Ostreni, me Nr. 182 Licence dhe Nr Nipti K31512070B, anëtar i Dhomës së Av. Tiranë.

KUNDËR : **Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokuror Julian Zonja.**

OBJEKTI: Heqje e sekuestros preventive të marrë me vendimin Nr. 1768, datë 26.11.2012 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 274/3 i Kodit Pr. Penale.

-Gjykata si shqyrtoi çështjen dhe dëgjoji palët;

VËREN

Kërkuestet E.D dhe A.M kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për arsye se kërkojnë që të hiqet sekuestroja preventive e marrë me vendimin Nr 1768 datë 26.11.2012,të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezulton e provuar se:

Me anë të Vendimit Nr 1768 datë 26.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e administruar në dosje është vendosur:

-Pranimin e kërkesës me Nr Akti 1768 që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Vendosjen e sekuestros preventive duke urdhëruar sekuestrimin e:

1. **Pasurive të paluajtshme:**

2. **Pasurive të paluajtshme:**

- A) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK.(.....) (.....), volum 10, faqe 174, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 2400 m2, regjistruar ne emër të (.....) në datën 7.11.2007 dhe pajisur me çertifikate pronësie në datën 7.11.2007.*
- B) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK.(.....) (.....), volum 3, faqe 173, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 300m2, regjistruar në emër të (.....) në datën 1.2.2007 dhe pajisur me çertifikate pronësie në datën 5.2.2007.*
- C) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK.(.....), volum 3, faqe 172, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500m2, regjistruar në emër të (.....) në datën 4.2.2007 dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 4.2.2007.*
- D) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 165, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000m2, regjistruar ne emër të (.....) në datën 1.2.2007 dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 5.2.2007.*
- E) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK.(.....), volum 1, faqe 109, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 600m2, regjistruar në emër të (.....) në datën 5.9.2007 dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 5.9.2007.*
- F) *pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK.(.....), volum 1, faqe 102, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000m2, regjistruar ne emër të (.....) në datën 23.2.2007 dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 1.3.2007.*

- G) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 1, faqe 112, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 600m², regjistruar ne emër të (.....) **në datën 1.2.2007** dhe pajisur me çertifikatë pronësie ne datën 5.2.2007.
- H) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 224, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 4050m², regjistruar në emër të (.....) **në datën 6.3.2007** dhe pajisur me çertifikatë pronësie ne datën 6.3.2007.
- I) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....) volum 28, faqe 74, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 4800m², regjistruar në emër të (.....) **në datën 26.6.2008** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 26.6.2008.
- J) pasuria me nr.(.....) e ndodhur në ZK(.....) (.....), volum 2, faqe 227, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500m², regjistruar në emër të (.....) **në datën 16.6.2008** dhe pajisur me çertifikate pronësie në datën 16.6.2008.
- K) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 7, faqe 161, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 69m² në rrugën “.....”, P....., shk....., Ap....., regjistruar në emër të (.....) **në datën 29.5.2008** dhe pajisur me çertifikate pronësie në datën 29.5.2008.
- L) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 1, faqe 40, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar në emër të (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- M) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 1, faqe 39, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar **ne emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- N) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 1, faqe 116, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar **ne emër të** (.....), **datë 27.2.2007** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 1.3.2007.
- O) pasuria me nr.(.....) e ndodhur në ZK(.....), volum 1, faqe 122, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar **ne emër të** (.....), **datë 26.10.2005** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 31.10.2005.
- P) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 146, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 600 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikate pronësie në datën 9.3.2006.
- Q) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 152, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.

- R) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 228, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 500 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 21.4.2005** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 22.4.2005.
- S) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 217, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1800 m2, regjistruar **ne emër të** (.....), **datë 10.1.2007** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 10.1.2007.
- T) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 17, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m2, regjistruar **ne emër të** (.....), **datë 26.5.2005** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 30.5.2005.
- U) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 124, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 2000 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- V) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 123, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1200 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- W) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 120, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- X) pasuria (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 166, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- Y) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 9, faqe 114, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 19.4.2004**, si ndarje pasurie.
- Z) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 246, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 21.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 21.3.2006.
- AA) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 245, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m2, regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.
- BB) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 242, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m2, regjistruar **në emër**

të (.....), **datë 21.4.2005** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 22.4.2005.

CC) pasuria me nr. (.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 239, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 1.2.2007** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 5.2.2007.

DD) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 2, faqe 236, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 21.4.2005** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 22.4.2005.

EE) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 151, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 9.3.2006** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 9.3.2006.

FF) pasuria me nr.(.....) e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 6, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1200 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 15.1.2004** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 26.1.2004.

GG) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 4, faqe 68, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1000 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 19.1.2004** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 19.1.2004.

HH) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 4, faqe 65, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1500 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 3.2.2004** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 6.2.2004.

II) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 11, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 2000 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 19.1.200** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 26.1.2004.

JJ) pasuria me nr.(.....), e ndodhur në ZK(.....), volum 3, faqe 12, lloji i pasurisë arë me sipërfaqe 1200 m², regjistruar **në emër të** (.....), **datë 19.1.2004** dhe pajisur me çertifikatë pronësie në datën 26.1.2004.

3. **Pasurive të luajtshme:**

- I. Automjeti me targë (.....), tipi (.....) (i blinduar), vit prodhimi 1996, në pronësi të shtetasit (.....).
- II. Automjeti me targë (.....) Mercedes Benz, tipi 211, model (.....), vit prodhimi 2004, në pronësi të shtetasit (.....).

- III. Automjeti me targë (.....), BMË, tipi AG(:.....), vit prodhimi 2005, në pronësi të shtetasit (.....).
- IV. Automjeti me targë TR (.....), (.....), tipi 9026, (.....) vit prodhimi 2006, në pronësi të shtetasit (.....).
- V. Automjeti me targë (.....) marka Audi (Coupe), tipi (.....) vit prodhimi 2007 në pronësi të shtetasës (.....).

4. **Llogarive në bankat e nivelit të dytë:**

- I. Llogaria e kursimit me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës IntesaSanpaolo në emër të shtetasës (.....).
- II. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës IntesaSanpaolo, në emër të shtetasës (.....).
- III. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën EURO pranë bankës IntesaSanpaolo, në emër të shtetasës (.....).
- IV. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën CHF (franga zviceriane) pranë bankës IntesaSanpaolo, në emër të shtetasit (.....).
- V. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në Lekë pranë bankës IntesaSanpaolo, në emër të shtetasit (.....).
- VI. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën EURO pranë bankës IntesaSanpaolo në emër të shtetasit (.....).
- VII. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës IntesaSanpaolo në emër të shtetasit (.....).
- VIII. Llogaria depozitë me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës IntesaSanpaolo, në emër të (.....) & (.....) e sipas vendimit të gjykatës nr.6617 akti, nr.1730 vendimi, datë 6.3.2009 në favor të (.....), i datëlindjes (.....).
- IX. Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën USD pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të (.....) & (.....).
- X. Llogaria e kursimit me (.....) në monedhën USD pranë Intesa Sanpaolo Bank, në emër të (.....) & (.....).
- XI. Depozitë kursimi fleksi në lekë me nr.(.....) pranë bankës Raiffeisen, në emër të (.....).
- XII. Llogari depozitë me nr.(.....) pranë bankës Raiffeisen, krijuar në datën 15.5.2009 sipas vendimit të gjykatës nr.6617 akti, nr. 1730 vendimi, datë 6.3.2009 në favor të (.....), i datëlindjes 15.1.1935.
- XIII. Llogari ngurtësimi për të investuar në Bono Thesari me nr.llogarie (.....) pranë bankës Raiffeisen, në emër të (.....).

- XIV. *Llogaria me nr.(.....) në lekë pranë bankës Raiffeisen, krijuar në datën 18.5.2009 sipas vendimit të gjykatës nr.6617 akti, nr.1730 vendimi, datë 6.3.2009 në favor të (.....), i datëlindjes 15.1.1935.*
- XV. *Llogaria rrjedhëse me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës Raiffeisen, në emër të (.....).*
- XVI. *Llogari depozitë me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës Raiffesisen, krijuar në datën 15.5.2009 me vendim gjykate nr.6617 akti, nr.1730 vendimi, datë 6.3.2009 në favor të (.....), i datëlindjes 15.1.1935.*
- XVII. *Llogari rrjedhëse mbështetëse depozitë me nr.(.....) në monedhën USD pranë bankës Raiffeisen, në emër të (.....).*
- XVIII. *Depozitë kursimi me nr.llogarie (.....) në lekë pranë Bankës Raiffeisen, në emër të shtetasit (.....).*
- XIX. *Depozitë kursimi me nr.llogarie (.....) në lekë pranë bankës Raiffeisen, në emër të shtetasit (.....).*
- XX. *Llogaria me nr.(.....) në monedhën EURO pranë bankës Veneto, në emër të (.....).*

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga pala brënda afateve ligjore në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-U shpall në Tiranë me datë 26.12.2012.

Sipas Aktit Noterial Nr 4574 Repertori,Nr 2166 Koleksioni datë 26.09.2014 të lëshuar në Zyrën e Notere Violeta Sulka Tiranë e administruar në dosje është vendosur:”Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënesin I.Dduke percaktuar si trashëgimtare të vetem ligjore të rradhës së parë E.D.”

Sipas certifikatës personale të lëshuar në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Nr 5 Tiranë në datë 10.11.2014 e administruar në dosje provohet se kerkuese E.D është e bija e I.D dhe A.M,e datëlindjes (.....),pra e mitur.

Sipas certifikatës familjare e lëshuar në Zyrën e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake Nr 5 Tiranë në datë 10.11.2014 e administruar në dosje,provohet se kerkuese A.M,jeton së bashku me fëmijën e vete,të mitur,kërkuesen E.D dhe figuron me gjëndje civile beqare.

Sipas Vendimit të datës 15.09.2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e përcjelle nga kjo Prokurori,kërkueses A.M,me shkresën Nr 4737 Prot,datë 16.10.2014 të administruara në dosje është vendosur:”Pushimi i

çështjes penale Nr 4737 të vitit 2012 për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287 të K.Penal.Në baze të nenit 275 të K.Pr.Penale,të urdhërohet konfiskimi i pasurive të sekuestruara.”

Prokurori pretendon se kjo kërkesë duhet të rrëzohet pasi sipas nenit 275 të K.Pr.Penale edhe pse është pushuar çështja penale është vendosur që këto sende duhet të sekuestrohen dhe se ato mund të lirohen vetem me vendim përfundimtar të gjykatës në gjykimin në themel të çështjes penale.Nuk është kjo gjykatë e cila duhet të gjykoj këtë kërkesë por gjykata që shqyrton çështjen në themel.”

Gjykata mendon se është kompetente për gjykimin e kësaj kërkesë pasi është kjo Gjykatë që ka lëshuar vendimin e masës së sigurimit për sekuestro preventive të këtyre sendeve.

Gjykata mendon se është kompetente për gjykimin e kësaj kërkesë dhe në zbatim të parimeve të trajtuara nga neni 274/3 të K.Pr.Penale.

Ky arsyetim shkon pershtat dhe me Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë 2 datë 20.06.2013.

Gjykata mendon se përderisa çështja penale është pushuar me vendim të Prokurorisë nuk ka se çfarë të gjykohet me vendim themeli të kësaj çështjeje.

Gjykata vëren se Prokuroria nuk provon se ne baze të parimeve të trajtuara nga neni 275/1 të K.Pr.Penale,sendet që ka urdhëruar të konfiskohen pas vendimit të pushimit,nga ai,të jenë prodhim ose përfitim nga vepra penale,ose kanë shërbyer apo ishin të destinuara për të kryer një veper penale.Prokuroria ka pasur një kohë mëse të mjaftueshme që nga viti 2012 për të provuar pretendimet e saj.

Sipas vertetimit të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tiranë me datë 10.11.2014,provohet se kërkuese A.M nuk rezulton të ketë procedim penal të rregjistruar në emër të saj.

Sipas shkresës me Nr 3150 datë 10.11.2014 e lëshuar nga Banka e Shqipërisë e administruar në dosje provohet se kërkuësja A.M,nuk ka ndonjë kredi për të shlyer.

Sipas shkresës me Nr 15821/1 datë 17.11.2014 e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e administruar në dosje provohet se kërkuese A.M nuk ka ndonjë çeshje civile në lidhje me pronat e sekuestruara, objekt gjykimi dhe ndonje mase sigurimi për to.

Nisur nga të gjitha këto Gjykata arsyeton se kërkueset nuk kanë ndonjë debi ndaj të tretëve që të pengoj nxjerrjen e një vendimi për të shfuqizuar masën e sekuestros preventive.

Gjykata mendon se kanë ndryshuar kushtet e zbatimit për këtë masë sekuestro dhe kjo duhet të hiqet, në kuptim të nenit 274/3 e K.Pr.Penale.

Gjykata mendon se kërkesa e kërkueseve duhet të pranohet si e mbështetur në ligj dhe në prova.

Për sa më sipër është e provuar me shpjegimet e palëve në seancë gjyqësore dhe gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në mbështetje të nenit 274/3 e K.Pr.Penale

VENDOSI

-Pranimin e kërkeses me Nr. Regj 1531 Them që i përket kërkueseve E.D dhe A.M .

-Heqjen e sekuestros preventive të marrë me vendimin Nr Regj 1768 Them datë 26.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palët brënda afateve ligjore në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-U shpall në Tiranë sot me datë 20.11.2014 .

SEKRETARE

JONIDA KURTI

GJYQTAR

ARTAN LAZAJ

